


INDEX ALBANIA



Projekti: INDEKS ALBANIA
Mbeshtetur nga Programi i Granteve
te Vogla i Komisionit per Demokraci,
Ambasada e SHBA ne Tirane

Ç'farë është Indeksi i Lirisë Ekonomike?

- Indeksi i Lirisë Ekonomike është themeluar nga nobelisti Milton Friedman për llogari të Institutit Fraser (Kanada).
- Tashmë ka më shumë se një dekadë që një indeks i tillë publikohet pas studimeve që kryhen në 141 vende të botës.
- Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike bashkëpunon me Fraser Institute për përgatitjen e Indeksit të Lirisë Ekonomike qysh nga viti 1996

Institucion i liberalizmit

- Indeksi bazohet në parimet e liberalizmit, pra të mosndërhyrjes së shtetit në ekonomi. Për pasojë, është një matës i mirë se sa liberale është një qeveri.

Treguesit kryesorë

- 1. PËRMASAT E QEVERISË NË EKONOMI
(sa më e vogël të jetë qeveria aq më mirë është)
- 2. SIGURIA E JETËS DHE E PRONËS
- 3. MUNDËSIA PËR TË PËDORUR PARA TË QËNDRUESHME
- 4. LIRIA E TREGTISË NDËRKOMBËTARE
- 5. RREGULLIMI I KREDITIMIT, PUNËS DHE BIZNESIT (sa më pak rregullime aq më mirë)

Shpjegimet

- 1) Indeksi tregon se një qeveri që ka nën kontroll një numër të vogël ndërmarrjesh publike, apo monopolesh publike, është më e mirë sesa një qeveri që kërkon të kontrollojë të gjithë ekonominë e vendit. (ky indeks nuk merr parasysh rastet kur kontrolli politik mbi segmentë të ndryshëm të ekonomisë ushtrohet në mënyrë indirekt.

Shpjegimet

- 2) Siguria e jetës dhe e pronës merr parasysh lehtësinë ligjore me të cilën një pronë shitet e blihet si dhe garantimin e individit/kompanisë se do ta gëzojë pronën që blen. Ky tregues është huazuar nga indeksi i të Bërit Biznes i Bankës Botërore. Është një tregues shumë domethënës, për shkak se ne që jemi shqiptarë e kuptojmë më mirë se sa e vështirë është të garantosh posedimin e pronës në vendin tonë.

Shpjegimet

3) Mundësia për të përdorur para të qëndrueshme (Sound Money) është një koncept ekonomik që shpjegon se sa të lehtë e kanë shqiptarët të përdorin një monedhë të pacënuar nga inflacioni. Nuk ka çudi që jemi renditur shumë mirë, për shkak se Shqipëria përdor lek/euro dhe dollarë, të treja monedha të qëndrueshme.

Shpjegimet

- 4) Liria e tregtisë ndërkombëtare mat koston shtesë fiskale që kanë qytetarët e një vendi kur tentojnë të shesin mallrat dhe shërbimet e tyre përtej kufijve shtetëror. Taksat doganore në hyrje apo në dalje, mungesa e liberalizimit të tregtisë, janë faktorë negativë.

Për vitin 2008 rezultatet e Shqipërisë ishin:

- 1. Për rolin e buxhetit të shtetit në ekonomi kemi renditje shumë të mirë, konsiderohemi në vend të 8 në rang botëror. (Nënkupto buxhet i vogël në raport me ekonominë).
- 2. Për të drejtat e pronësisë dhe mbrojtjen ligjore kemi dalë shumë keq, në vend të 92 në rang botëror. (Kjo na klasifikon në vendet gjysëm diktatoriale).
- 3. Aksesit të monedhat e forta jemi shkëlqyeshëm, renditemi në vend të 7 në botë. Politika e kujdesshme monetare ka ndihmuar në këtë vlerësim.

Për vitin 2008 rezultatet e Shqipërisë ishin:

- 4. Liria për tregti ndërkombëtare, na rendit në vend të 112, pranë fundit të listës.
- Kuadri rregullativ, eg, lincenca etj., na rendit në vend të 113, pra në fund të listës
- Rregullimi i tregut të kredive, na rendit në vend të 119, pra konsiderohemi tepër të ngurtë në kreditim.
- Edhe te rregullimi i tregut të punës, apo te rregullimi i biznesit, jemi në fund të listës.

Kritikat

- Indeksi i Institutit Fraser kritikohet kryesisht nga e majta për arsye parimore. Psh. Roli i qeverisë në ekonomi: Milton Friedman besonte se qeveria duhej të zinte sa më pak tregje dhe sasia më e madhe e parave duhej t'i lihej në dorë individit, ndërkohë që e majta beson te shteti social dhe te roli i buxhetit të shtetit si rishpërndarës të ardhurash.

Kritikat

- Natyrisht, rasti i Shqipërisë është krejt i ndryshëm. Me parametrat e institutit Fraser, roli i buxhetit të shtetit në ekonomi ka qenë shumë i ulët që pas vitit 1994, pa dallim se kush ka qenë në qeveri. Buxheti i vogël nuk ka qenë as çështje zgjedhjeje.
- Pra nuk është se qeveritë shqiptare kanë zgjedhur të mbajnë një buxhet të vogël, apo një buxhet të madh për arsye parimore.

Ka thënë Milton Friedman

- “Historia dëshmon se liria ekonomike është parakusht për lirinë politike, por nuk është i mjaftueshëm më vete”
- “Argumentimi kundër tregut të lirë dëshmon mungesë besimi te vetë liria”
- “Qeveritë nuk mësojnë kurrë, vetëm njerëzit mësojnë”